



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 126 Prot.

Tiranë, më datë 31.05.2024

VENDIM
Nr. 126, datë 31.05.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saç”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 31.05.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të koncept idesë për projektin “Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe Masterplani i Vlerësimit të Turizmit të Kalasë së Gjirokastrës”, Faza 1 - Faza 5, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues dhe zhvillues subjekti **Metro Polis sh.p.k.**;
2. Projekt ideja do të shqyrtohet sipas formës së aplikimit (i ndarë në paketa të veçanta) sipas fazave të përcaktuara në koncept ide;
3. Hartimi i projekt - idesë duhet të përfshijë të gjitha ndërhyrjet restauruese dhe konservuese për të gjithë Pasurinë Kulturore të Kalasë së Gjirokastrës, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë;
4. Gjuha arkitektonike e propozuar duhet të harmonizohet me tipologjinë e Pasurisë Kulturore, me teknikat e ndërtimit dhe materialet tradicionale;
5. Pjesë e projekt – idesë duhet të jetë edhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Trashëgimi;
6. Projekt – ideja të shoqërohet më një koncept të Linjës muzeale të propozuar;
7. Projekti të përcillet për mendim teknik në UNESCO;
8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
9. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
10. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

